



PJESA A: Çdo përgjigje e saktë vlerësohet me 3 pikë


1. Gjashtë pika janë të numëruara si në figurë. Kaltrina vizaton dy trekëndësha, një duke bashkuar pikat me numrat çift dhe një duke bashkuar pikat me numrat tek, dhe ngjyros njërin trekëndësh përbrenda me ngjyrë të kuqe, kurse tjetrin me ngjyrë te gjelbër. Cila nga pesë mundësítë e tregon figurën që vizaton Kaltrina?



(A)



(B)
(D)




(E)

1 • 5
2 • 4
6 • 3


2. Erona lundroi me barkë rrreth pesë ishujve, si në figurë. Rrreth cilave ishuj lundroi Erona në kahun e kundërt të akrepave të orës?

(A) 1 dhe 4
(C) 2 dhe 3
(E) 1 dhe 3


(B) 2, 3 dhe 5
(D) 1, 4 dhe 5



3. Rrezet e lazerit reflektohen në pasqyra siç tregohet në figurë.



Te cila shkronjë do të përfundojë rrezja e lazerit?



- (A) A
(D) D
(B) B
(E) E
(C) C

4. Numrat cistercianë janë përdorur në fillim të shekullit të trembëdhjetë. Cilido numër natyror nga 1 deri 99 mund të shkruhet nga një figurë e vetme që formohet duke kombinuar dy nga figurat e treguarat.





Figura për 24 duket kështu: , figura për 81 duket kështu:

dhe figura për 93 duket kështu:

Si duket figura për 45?





5. Plakat e mermerit shiten në paketa nga 5, 10 ose 25 sosh. Taulanti blen saktësisht 95 plaka të mermerit. Sa është numri më i vogël i paketave që mund të blejë ai?

6. Le të jetë $ABCD$ katror me gjatësi të brinjës 10 cm . Sa është syprina e sipërfares së pjesës së hijëzuar?


- (A) 40 cm^2 (B) 45 cm^2 (C) 50 cm^2
 (D) 55 cm^2 (E) 60 cm^2

7. Në garazhën që tregohet në figurë, makinat mund të lëvizin vetëm para ose prapa por nuk mund të kthehen. Sa është numri më i vogël i makinave që duhet të lëvizin në mënyrë që makina e zezë të mund të dalë nga garazha?



8. Gresa ka një fije spageti të gjatë të cilën duhet ta shkurtojë. Secilën herë që ajo e ndan një pjesë të spagjetit, fija ndahet në tri pjesë si në figurë. Me cilët nga numrat vijues të pjesëve nuk mund të përfundojë ajo?

- (A) 13 (B) 17 (C) 20 (D) 23 (E) 25



9. Besniku i rivendos shtatë pjesët e treguara që ta fitojë numrin më të vogël të mundshëm 12-shifrорë.


4 69 113 9 51 5 67

Cilat janë 3 shifrat e fundit të ketij numri?

- (A) 699 (B) 113 (C) 551 (D) 967 (E) 459


- 10.** Për cilën nga pjesët e mëposhtme të një rrotullimi të plotë duhet të rrotullohet rrata e Ferrisit, ashtu që një kabinë e bardhë të jetë në majë?

- (A) $\frac{1}{2}$ (B) $\frac{1}{3}$ (C) $\frac{1}{6}$ (D) $\frac{1}{12}$ (E) $\frac{5}{6}$




PJESA B: Cdo përgjigje e saktë vlerësohet me 4 pikë

- 11.** Pesë elefantë të mëdhenj dhe katër elefantë të vegjël janë duke ecur përgjatë një rruge, si në figurë. Kur ata arrijnë kryqëzimin, secili elefant shkon ose majtas ose djathtas. Cila nga figurat e mëposhtme nuk e paraqet një situatë të mundshme pasi të gjithë elefantët e kalojnë kryqëzimin?




-

- 12.** Kaona fillon me numrin 12 dhe ndjek shigjetat duke përdorur rregullat e treguara në figurën në të majtë.



Me cilin num r do t  p rfundoj  ajo?



- 13.** Mali dhe shokët e tij e ndërtuan numrin 2022 me 66 kubë, si në figurë. Ata ngjyrosën sipërfaqen e strukturës me ngjyrë hiri. Sa nga kubet kanë saktësisht 4 faqe të ngjyrosura?




- (A) 16 (B) 30 (C) 46 (D) 54 (E) 60

14. Një rezervuar i ujit me bazë drejtkëndëshe ka dimensione $1\text{ m} \times 2\text{ m} \times 4\text{ m}$. Ai mban ujë deri në thellësi 25 cm , si në figurën e majtë. Rezervuari kthehet në mënyrë që njëra faqe me dimensione $1\text{ m} \times 2\text{ m}$ bëhet baza, siç tregohet në figurën e djathtë. Sa është thellësia e ujit tanë?






- (A) 25 cm (B) 50 cm (C) 75 cm
 (D) 1 m (E) 1.25 m




15. Figura tregon një copë letre transparente me një dizajn të vizatuar në të. Letra pastaj paloset dy herë, siç tregohet.



Cka do të shihet në fletën e palosur?

- (A)  (B)  (C) 
 (D)  (E) 

16. Syprina e katrorit është 100 cm^2 .



Sa është syprina e pjesës së hijëzuar?


- (A) 20 cm^2 (B) 25 cm^2 (C) 30 cm^2 (D) 35 cm^2 (E) 40 cm^2

17. Viti 2022 është i veçantë sepse shifra 2 shfaqet tri herë. Kjo është hera e tretë që breshka e quajtur Eva ka jetuar në një vit të tillë me tri shifra identike. Në fund të vitit 2022, sa është mosha më e vogël e mundshme e Evës?

- (A) 18 (B) 20 (C) 22 (D) 23 (E) 134

18. Artani dëshiron ta plotësojë figurën ashtu që çdo rresht, çdo kolonë dhe cilëtdo katër rrathë të bashkuar me segmente të drejta përmbajnë katër numrat 1, 2, 3 dhe 4. Cilin numër duhet ta shkruajë ai në rrethin që përban pikëpyetjen?

- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4
 (E) Nuk mund të përcaktohet




19. Liza ka 4 qenë. Secili nga 4 qentë peshon një numër të plotë të kilogramëve (kg). Asnjë prej tyre nuk peshojnë njësoj. Së bashku, ata peshojnë 60 kg. Qeni i dytë më i rendë peshon 28 kg. Sa peshon qeni i tretë më i rendë?

- (A) 2 kg (B) 3 kg (C) 4 kg (D) 5 kg (E) 6 kg


20. Jerina shkruan shtatë numrat 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 në rrathët në figurë ashtu që shumat e tre numrave në secilin segment të drejtë janë të nejta. Sa është shuma më e madhe e tre numrave në segment që mund ta arrijë Jerina?

- (A) 28 (B) 18 (C) 22 (D) 16 (E) 20



PJESA C: Çdo përgjigje e saktë vlerësohet me 5 pikë

21. Një grumbull gotash janë të vendosura mbi njëra-tjetën. Një grumbull me 8 gota është i lartë 42 cm, kurse një grumbull me 2 gota është i lartë 18cm. Sa është lartësia e një grumbulli me 6 gota?







- (A) 22 cm (B) 24 cm (C) 28 cm (D) 34 cm (E) 40 cm

22. Në figurën e mëposhtme, secila kafshë përfaqëson një numër natyror dhe kafshët e ndryshme përfaqësojnë numra të ndryshëm. Shuma e dy numrave në secilën kolonë është shkruar poshtë kolonës përkatëse. Sa është shuma më e madhe e mundshme e katër numrave në rreshtin e parë?

				?
15	11	3	7	

- (A) 18 (B) 19 (C) 20 (D) 21 (E) 22

23. Për të hapur këtë kyç, ju merrni katër sugjerimet e mëposhtme.



Një nga shifrat është e saktë dhe në vendin e duhur.

Një nga shifrat është e saktë por jo në vendin e duhur.

Dy nga shifrat janë të sakta, por në vendet e gabuara.

Të gjitha shifrat janë gabim.

Cili është kodi i saktë për të hapur kyçin?

(A) 604







(B) 082

(C) 640

(D) 042

(E) 046

24. Ana ka trupin e treguar në të djathtë. Cili nga trupat e mëposhtëm është i njejtë me atë të Anës?



25. Verona zgjedh katër nga numrat 2, 3, 4, 5 dhe 6 dhe e vendos një në secilën kuti në mënyrë që barazimi të jetë i saktë. Sa nga pesë numrat mund ta shkruajë Verona në kutinë e hijëzuar pas shenjës së barazimit?

$$\square + \square - \square = \square$$

(A) 1


(B) 2

(C) 3

(D) 4

(E) 5

26. Numrat 3, 4, 5, 6 dhe 7 duhet të vendosen në pesë rrathët e mëposhtëm në mënyrë që numri brenda secilit trekëndësh të jetë prodhimi i tre numrave në kulmet e tij.



Sa është shuma e tre numrave në kulmet e trekëndëshit të ngjyrosur?

(A) 12






(B) 14

(C) 15

(D) 17

(E) 18

27. Cila nga rrjetat në vijim nuk mund të paloset që të formohet trupi i ngurtë ?



28. Katër fshatrat A, B, C dhe D ndodhen përgjatë një rruge në këtë renditje. Distanca mes fshatrave fqinje është 10 km. Në fshatin A jetojnë 10 nxënës, 20 nxënës jetojnë në fshatin B, 30 nxënës jetojnë në fshatin C dhe 40 nxënës jetojnë në fshatin D. Fshatarët dëshirojnë të ndërtojnë një shkollë ashtu që distanca e gjithmbarshme të cilën e kalojnë nxënësit për të shkuar në shkollë të jetë sa më e vogël që është e mundur. Ku duhet ta ndertojnë ata shkollën?




- (A) në A
(D) në C

- (B) në B
(E) në D

- (C) në mes të B dhe C

29. Tri figurat tregojnë një strukturë të ndërtuar nga kubet siç shihet nga sipër, nga para dhe nga e djathta. Sa është numri më i madh i kubeve që ka qenë e mundur të përdoren për të ndërtuar strukturën?

- (A) 18 (B) 19 (C) 20 (D) 21 (E) 22



30. 30 njerëz janë ulur rrreth një tavoline rrethore. Disa nga ta kanë të vendosur kapele. Ata që kanë kapele gjithmonë tregojnë të vërtetën, kurse ata të cilët nuk kanë kapele mund ose të gënjejnë ose të tregojnë të vërtetën. Secili nga ta thotë “të paktën njëri nga dy njerëzit që i kam pranë nuk ka të vendosur kapelë”. Sa është numri më i madh i njerëzve që mund të jenë me kapele?

- (A) 5 (B) 10 (C) 15 (D) 20 (E) 25